

Thirrja për nominime- Çmimi Vjetor për Zyrtarin e Dalluar Komunal

Të nderuar qytetarë,

Në këtë periudhë të fundvitit, me qëllim të vlerësimit publik për shërbim të jashtëzakonshëm në administratën komunale dhe përfshirjen e qytetarëve, është momenti për të vendosur në qendër të vëmendjes ata zyrtarë komunal të cilët kanë treguar përkushtim të jashtëzakonshëm në përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse duke ndikuar pozitivisht në adresimin e çështjeve në komunitet.

“Komisioni për Çmimet e Mirënjohjes Publike”, ka kënaqësinë që të shpallë të hapur procesin e nominimeve për “Çmimin vjetor për zyrtarin e dalluar komunal”.

Me këtë rast, komisioni do të vlerësojë kandiduarat e të gjithë të nominuarve që pranohen në formatin e nominimeve të hapura për zyrtarët komunal, që në kuadër të përmbushjes së detyrës publike, kanë përfshirë qytetarët në vendimmarrjen lokale në mënyrë proaktive, duke ndikuar pozitivisht në formësimin e politikave lokale si dhe adresimin e sfidave dhe problemeve të komunitetit.

Të nominuarit duhet të jenë zyrtarë komunal të cilët gjatë përmbushjes së detyrës publike kanë promovuar dhe demonstruar ndershmërinë, integritetin, shërbimin ndaj qytetarëve, neturalitetin, objektiviteten dhe transparencën; dhe së paku të plotësojnë tre nga kriteret si vijon:

- Të ketë përfshirë në mënyrë aktive qytetarët në proceset e vendimmarrjes publike në nivelin lokal të qeverisjes si dhe adresimit të çështjeve të komunitetit
- Të ketë promovuar dhe mbajtur një komunikim të vazhdueshëm dhe transparent për vendimet dhe aktivitetet e komunës në raport me qytetarët
- Të ketë siguruar që proceset e vendimmarrjes lokale të përfshijnë perspektivën e qytetarëve si dhe përfshirjen e grave, komunitetet pakicë, të rinjtë dhe personave me aftësi të kufizuara, në proceset e disajnit të politikave lokale
- Të ketë ndërtuar një partneritet dhe dialog të strukturuar me bizneset, shoqërinë civile, mediat në procesin e formulimit dhe zbatimit të politikave lokale

Për të nominuar një zyrtar komunal për “Çmimin vjetor për zyrtarin e dalluar komunal”, Ju lutem, vizitoni faqen zyrtare të internetit të komunës në linkun si vijon: www..... ku do të gjeni të gjitha detajet lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si dhe të plotësoni formularin e nominimit.

Nominimet do të pranohen deri me datë 12 Dhjetor 2023.

Le të bashkohemi në këtë iniciativë të përbashkët për të vlerësuar zyrtarin i cili ka treguar përkushtim të lartë për përmbushjen e detyrave publike, duke përfshirë qytetarët në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse, i cili bashkëpunim ka reflektuar në ndryshime positive dhe transformuese në komunitetin tone.

Pjesëmarrja juaj përmes nominimit të kandidaturave është thelbësore për të vlerësuar publikisht përpjekjet e atyre që gjatë përmbushjes së mandatit si zyrtar publik janë përkushtuar për të adresuar çështjet e komunitetit dhe për të rritur rolin e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale.

Ju faleminderit për nominimet tuaja!

Anëtarët e Komisioni Komunal për Çmimet e Mirënjohjes Publike